



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. ....<sup>152</sup>..... Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 27/ 12 / 2022

**VENDIM**

Nr.33, date 27 /12/2022

**PËR**

**RREGULLOREN E SHFRYTEZIMIT, OPERIMIT, MIREMBAJTJES, MONITORIMIT DHE  
SIGURISE SE DIGES SE HEC OKSHTUN**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytezimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregulloreve për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 27.12.2022 mori në shqyrtim Rregulloren e shfrytezimit, operimit, monitorimit dhe sigurisë së digës së HEC Okshtunit të paraqitur nga Shoqëria DITECO shpk.

Dokumentacioni i kësaj rregulloreje të dorëzuar pranë SKDM ka përfshirë kërkesat e udhëzimit të KKDM në lidhje me hartimin e këtyre rregulloreve të shprehura në Vendimin e KKDM Nr. 3, dt.19.10.2020. KTPD i rekomandoi antareve të KKDM të miratojnë rregulloren për shfrytezimin e digës së HEC Okshtunit duke patur parasysh që në këto rregullore të përditesohet rregullorja e shkarkimit të plotave duke përfshirë edhe prurjet e mëdha që vijnë një herë në 100 vjet dhe një herë në 50 vjet. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

**VENDOSI:**

- 1- Të miratojnë Rregulloren e Shfrytëzimit, Operimit, Mirembajtjes, Monitorimit dhe Sigurisë së digës së HEC Okshtunit të paraqitur nga Shoqëria DITECO shpk.
- 2- Të kërkojnë shoqërisë DITECO shpk:
  - Përditesimin e rregulloreve të shkarkimit të plotave të mëdha duke përfshirë edhe shkarkimet për shkak të prurjeve të mëdha që vijnë një herë në 50 vjet dhe një herë në 100 vjet. Për këto raste, kompania DITECO shpk duhet të parashikojë informimin e institucioneve përkatëse duke përfshirë pushtetin lokal, prefekturën, AKMC dhe KKDM në kohe reale dhe përpara hapjes së portave të shkarkimit;

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë Vendim sipas legjislacionit në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**

